

VENDIM
Nr. 220, datë 4.7.2023

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME APLIKIMIN E SHOQËRISË “NOVA SOLAR SYSTEM” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1319/9 prot., datë 3.7.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë ‘Nova Solar System’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 159, datë 5.5.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 50 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 6.5.2023 dhe 8.5.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 4.6.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1319/5 prot., datë 18.5.2023, ERE iu drejtua shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k., duke e njoftuar për fillimin e procedurës për licencim dhe për zhvillimin e një seance dëgjimore, me qëllim plotësimin e pjesës tjetër të dokumentacionit të konstatuar të munguar.

- Pas korrespondencës së zhvilluar mbi dokumentacionin e mbetur pa plotësuar, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e fundit plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. nr. 1319/8 prot., datë 29.6.2023.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar nga shoqëria në kuadër të këtij aplikimi, vlerësohet të zgjatet deri në 20 (njëzet) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 50 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti